LIGJ
Nr.9713, datë 16.4.2007

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8560, DATË 22.12.1999 "PËR PROCEDURAT TATIMORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr.8560, datë 22.12.1999 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Neni 37 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 37
Pagimi i tatimeve, taksave dhe kontributeve

1. Pagimi i tatimeve, taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore është i detyrueshëm brenda afateve të përcaktuara me ligje të veçanta tatimore.

2. Pavarësisht nga dispozitat e parashikuara në këtë ligj apo në ligje të tjera të veçanta tatimore, shuma e detyrimit për t'u paguar nga tatimpaguesit, me vlerë deri në 1 000 (një mijë) lekë, në përputhje me deklaratën tatimore apo vlerësimin tatimor, trajtohet si detyrim në vlerë zero.".

Neni 2

Neni 41 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 41
Pagesa me këste

Në raste të veçanta dhe të argumentuara me gjendjen financiare, kur një tatimpagues nuk mund të paguajë plotësisht dhe menjëherë detyrimin tatimor, organi tatimor përkatës, sipas kërkesës me shkrim, mund të hartojë një plan pagese me këste. Në raste të tilla, tatimpaguesi paguan interesat për të gjithë kohëzgjatjen e pagesës me këste. Plani i pagesës me këste është një marrëveshje me shkrim, e përgatitur sipas përcaktimit në Kodin Civil dhe e nënshkruar nga kryetari i degës përkatëse të tatimeve, si dhe nga tatimpaguesi. Plani i pagesës me këste anulohet kur kushtet, në të cilat është hartuar, nuk ekzistojnë më.

Rregullat, procedurat dhe kohëzgjatja e pagesës me këste përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave.".

Neni 3

Neni 43 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 43
Detyrimi për pagesë të menjëhershme

1. Para se të paraqiten për apelim në shkallët e apelimit administrativ, tatimpaguesit janë të

detyruar të parapaguajnë detyrimin tatimor, pa përfshirë interesat dhe gjobat që lidhen me këtë detyrim.

2. Para se të paraqiten për shqyrtim gjyqësor, tatimpaguesit janë të detyruar të paguajnë 15 për qind të çdo gjobe dhe interesi. Shqyrtimi gjyqësor i çështjeve zhvillohet sipas një procedure gjyqësore të përshpejtuar, e cila nuk duhet t'i kalojë 60 ditë.

Administrata tatimore detyrohet të bëjë ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, në të kundërt zyrat e përmbarimit i ekzekutojnë ato menjëherë.".

Neni 4

Neni 49 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 49
Shkeljet dhe dënimet për regjistrimin

1. Kryerja e veprimtarisë pa u regjistruar në organet tatimore dhe pa u pajisur më parë me certifikatën tatimore është shkelje dhe dënohet si më poshtë:

a) me bllokim të veprimtarisë, deri në regjistrimin e tatimpaguesit dhe pajisjen e tij me certifikatë tatimore. Në rastin e transportit, ky dënim shoqërohet me marrjen e lejes së qarkullimit të automjetit të paregjistruar dhe të papajisur me certifikatë tatimore;

b) me sekuestrim të pasurive në vendin e biznesit, kur tatimpaguesi, ndaj të cilit është marrë masa e bllokimit, gjendet duke ushtruar veprimtarinë.

2. Mosnjoftimi në degën e tatimeve i ndryshimeve në regjistrim, që kanë të bëjnë me adresën e vendit të ushtrimit të veprimtarisë, është shkelje dhe dënohet si më poshtë:

a) me bllokim të veprimtarisë, deri në regjistrimin e adresës së re të vendit të ushtrimit të saj dhe pajisjen e saj me certifikatë dytësore tatimore. Në rastin e transportit, ky dënim shoqërohet me marrjen e lejes së qarkullimit të automjetit të paregjistruar dhe të papajisur me certifikatë dytësore tatimore;

b) me sekuestrim të pasurive në vendin e ri të biznesit, kur tatimpaguesi, ndaj të cilit është marrë masa e bllokimit, gjendet duke ushtruar veprimtarinë.".

Neni 5
Neni 52 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 52
Shkeljet dhe dënimet për mosdokumentim

Ruajtja, përdorimi dhe transportimi i mallrave pa dokumentacionin e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave, në zbatim të këtij ligji, është shkelje dhe dënohet me sekuestrimin e mallrave të padokumentuara.".

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.